



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 03.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.11.2022 të parashtruar nga **OE Gashi EG SH.P.K. nga Lipjani**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit”** me nr. të Prokurimit **613-22-11238-5-2-1**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim, **OE Gashi EG SH.P.K. nga Lipjani**, me titull: **“Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit”** me nr. të Prokurimit **613-22-11238-5-2-1**.

Vërtetohet: Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit të publikuara në platformën e prokurimit të datës: 14.10.2022. dhe formulari B54 për korigjimin e gabimeve të datës 01.11.2022.

1. **Mbetet në fuqi** Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit të datës: 14.11.2022. dhe formulari B54 për korigjimin e gabimeve të datës 01.11.2022
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE Gashi EG SH.P.K. nga Lipjani ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit**” me nr. të Prokurimit **613-22-11238-5-2-1**. Lidhur me kushtet e pjesëmarrjes të parashtrura nga AK.

Pergjigje per pretendimin e juaj te Parë

AK gjate zhvillimit te procedurave pikerisht kushtet per pjesemarrje i vendos duke u bazuar ne rendesine e projektit dhe nenin 7 te LPP, dhe ne asnje rast AK nuk vendos kritere diskriminuese per OE. Keto kerkesa jane te bazuara ne projektin (paramasen) ne fjale.

Inxhinieri qe eshte kerkuar ka te beje direkt me projektin ne fjale sepse ka te beje me infrastrukture dhe eshte projekt qe zgjate 36 muaj, poashtu neve kemi ulur pervojen e punes nga 6 ne 3 vjet dhe kemi shtuar qe i njejti mund te jete bachelor apo master ky ndryshim eshte publikur me date 02.11.2022 ne platformen e prokurimi.

Ky pretendim i juaji eshte i pabazuar.

Pergjigje per pretendimin e juaj te Dytë

AK gjate zhvillimit te procedurave pikerisht kushtet per pjesemarrje i vendos duke u bazuar ne rendesine e projektit dhe nenin 7 te LPP, dhe ne asnje rast AK nuk vendos kritere diskriminuese per OE. Keto kerkesa jane te bazuara ne projektin (paramasen) ne fjale.

Pretendimet tuaja per disa nga mjetet e punes qe nuk jane te nevojshme dhe tonazha nuk nevojitet neve duhet te ju njoftojme qe kemi te beje me nje projekt qe zgjate 36 muaj dhe qe te gjitha nga mjetet e parapra jane me se te nevojshme per kete projekt dhe jane mjete qe lidhen me projektin ne fjale poashtu duhet te ju sqarojme qe per qdo pune qe do te realizohet kerkohen mjete adekuate per punen e caktuar sepse eshte kontrate e mirembajtjes dhe nevojitet qe punet te realizohen ne menyre profesionale ne terren. Sa i perket mjeteve te punes qe ju eshte caktuar tonazha ne min apo max eshte e nevojshme sepse duhet te caktohet se me qfar lloj mjetesh te punohet dhe duhet te ju sqarojme qe nuk eshte vendos tonazhe fikse ne asnje mjet pune.

Sqarim shtese disa nga kriteret kane ndryshuar qe lidhen edhe me kerkese per risqyrtim nga ana e juaj per mjetet e punes dhe ndryshimet jane publikuar me date 02.11.2022.

Ky pretendim i juaji eshte i pabazuar.


AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit